



Business Newsletter

Korrik, Issue 3

2017

Kompanitë kombëtare, prodhuesit dhe eksportuesit të kontribuojnë në prosperitetin e Shqipërisë përmes rritjes dhe performancës konkurruese në tregjet e brendshme dhe globale.

Në brendësi



- Qeveria, konsultime me anëtarët e AFI dhe AlbExport
- 11 propozime nga anëtarët e AFI dhe AlbExport
- Alban Zusi: Dëgjesat e Ramës risi. Reformë në administratë dhe sigurinë ushqimore
- Prodhuesit e bulmetit kërkojnë rregull dhe standarde
- Kuotat e përpunimit të peshkut, rrezikohen mijëra vende pune
- Grup pune DPT-AFI për problematikat e industrisë së qumështit
- Zgjidhet kryetari dhe bordi drejtues i "Komitetit të Industrisë së Qumështit"
- Tre kompani antarësohen në AFI dhe Alb Export
- LEGJISLACIONI

Qeveria, konsultime me anëtarët e AFI dhe ALBExport

NikoPeleshi, kreu i grupit të punës ngarkuar nga kryeministri Edi Rama, për organizimin administrativ në çdo sektor, zhvilloi katër takime konsultative me anëtarët e AFI dhe AlbExport.

Përfaqësuesit e bizneseve që operojnë në sektorët e përpunimit të qumështit, mishit, thertoreve dhe agro-përpunimit i paraqitën, **Z.NikoPeleshi** problematikat dhe zgjidhjet që ata mendojnë për sektorët ku operojnë.

Alban Zusi Drejtor Ekzekutiv i AFI, tha se kjo dëgjesë vjen me kërkesë të Z.NikoPeleshi, për të dëgjuar shqetësimet nga biznesi.

"Është e rëndësishme të ndërtojmë një kanal komunikimi e permanent me Qeverinë për zgjidhjen e problemeve. Zgjidhjet duhet të burojnë nga ne. E falënderojmë Z. Peleshi për këtë iniciativë, pasi ne sot hedhim shinat për një bashkëpunim të vazhdueshëm, mes biznesit dhe qeverisë" tha Zusi.





Procesi mbledhjes së problematikave dhe sugjerimeve përzgjidhje vijon në platformën

<http://afi.albania-export.com>

në Websitin e AFI

dhe në Facebook

www.facebook.com/PlatformABU/

Gjatë këtyre dy muajve deri në formimin e qeverisë së re, tha Z. Peleshi, ne do të hartojmë një strukturë eficiente, të agjencive tona atje ku ka nevojë për ndërhyrje.

“Bujaësia është një sektor i pa konkurrencës. Duhet ndërhyrje të forta për të arritur standarde. Nga këto takime ne synojmë një fotografim të gjendjes sot dhe si do të jetë struktura, ku me rëndësi është siguria ushqimore. Na duhet të identifikojmë problemet dhe zgjidhjet për to” deklaroi Z. Peleshi.

Në këto katër takime kryefjala e sipërmarrjes shqiptare ishte formalizimi i ekonomisë, pasi sipas tyre nëse nuk merr fund informaliteti, atëherë çdo hap që do të ndërmarrë qeveria nuk do të jetë efikas.

Stafi edhe ekspertët e AFI në bashkëpunim edhe me stafin e Z. Peleshi po vijnë strukturimin e çështjeve dhe mbi të gjitha përgatitjen e propozimeve konkrete për zgjidhjen e tyre, me një axhendë kohore qartësisht të përcaktuar për pjesën takuese të institucioneve publike si përshtetull 'brenda 100 ditëve të para', 'brenda 300 ditëve' etj.

11 propozime nga anëtarët e AFI dhe AlbExport

Në mënyrë të përmbledhur 11 idetë dhe problematikat që janë konsoliduar deri tani, gjatë takimeve dhe komunikimeve me anëtarët e AFI dhe AlbExport.

- 01 Domosdoshmëria e formalizimit të ekonomisë – mjetet, metodat, sikurse standardizimi i lëndëve të para – cilësia e qumështit, mbetjet e kimikatave në fruta - perime për eksport, etj.
- 02 Transparenca e procesit të subvencioneve – reformimi total i skemës dhe kriterëve të shpërndarjes.
- 03 Ngarkesa e lartë fiskale për produktet ushqimore – TVSh 20% më e larta në rajon dhe Europë për ushqimet.
- 04 Stadar ushqimor unik për njësitë prodhuese – jo më stadarde të sigurisë ushqimore të diferencuara (thertore e vogël apo thertore e madhe, ose baxho djathi apo fabrikë qumështi, etj.).
- 05 Nevoja e një auditi ndërkombëtar për certifikimin e stabilimenteve aktuale prodhuese – modeli i akreditimit të universiteteve në vitin 2014 si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të propozuar nga bizneset në të gjitha bordet dhe organizmat konsultativ të qeverisë.
- 06 Nevoja për programe kombëtare për çështje sensitive si vendosja e sigurisë ushqimore, rritja e stadardit cilësor të qumështit etj.
- 07 Unifikimi i kontrolleve që kryhen nga inspektoriate të ndryshme – aktualisht bizneset kontrollohen nga 12 inspektoriate.
- 08 Rishikim i kuadrit ligjor fiskal për grumbullimin e fruta perimeve – pagesat ndaj fermerëve, mosrimbursimi i TVSH së autofaturuar për eksportet.
- 09 Rimbursimi i TVSH dhe taksave për inputet bujqësore e karburantin e kondicionuar me detyrimin për respektim të stadardeve dhe formalizim të prodhimit.
- 10 Stadarizimi i krijimit dhe funksionimit të qendrave të grumbullimit.
- 11 Projekte kombëtare për zhvillimin e sektorëve specifik – paketë masash nxitëse për prodhimin në vend të mishit të dërrit për nevojat e konsumit vendas (i freskët dhe për industrinë) çka rrit ndjeshëm punësimin, zhvillimin e bizneseve të reja dhe konkurrueshmërinë e atyre ekzistuese, si dhe nxit punimin e tokës dhe kultivimin e saj për sigurimin e bazës ushqimore. Vetëm kjo masë përmirëson me mbi 60 milion Euro në vit bilancin e import-eksporteve.



Alban Zusi: Dëgjesat e Ramës risi. Reformë në administratë dhe sigurinë ushqimore

Alban Zusi president i “Qendrës së Eksporteve Shqiptare” dhe drejtor ekzekutiv i “Albanian Food Industry”, i quan një hap pozitiv dëgjesat e iniciuara nga kryeministri Edi Rama, menjëherë pas fitimit të zgjedhjeve.

“Kjo praktikë sjellje e një force politike fituese që menjëherë pas zgjedhjeve fillon një proces konsultimi me qytetarët dhe grupet e interesit për politikëbërjen dhe mirëadministrimin e vendit, është një risi shumë shpresëdhënëse. Këto konsultime tregojnë se ka një interes real për të ndryshuar ato çka realisht shqetësojnë qytetarin shqiptar.

Mendoj se janë disa reforma të cilat duhet të ndërmarrë qeveria e re.

Ka një kategori reformash që quhen reforma sistematike, që ndihmojnë për të ndërtuar sistemet, që i shërbejnë më pas të gjithë ekonomisë dhe padyshim, kjo do të ishte reforma në administratën publike.

E tillë është reforma e sigurisë ushqimore, pasi nisja e një reforme të tillë nga qeveria e re, është e lidhur me shëndetin e njerëzve.

Qendra e Eksporteve Shqiptare dhe Albanian Food Industry si grup interesi, do të ushtrojmë të gjithë influencën për të bindur kryeministrin Edi



Rama, në domosdoshmërinë e një iniciative kombëtare nën drejtimin e tij, për sigurinë ushqimore” u shpreh Alban Zusi.



Industria e përpunimit të peshkut po gjendet përballë vështirësive, pasi plotësimi i kuotave vjetore të eksportimit të peshkut të konservuar, nuk po u mundëson të punojnë me kapacitet të plotë dhe as të zgjerohen më tej.

Për shkak të zgjerimit të kësaj industrie, kuotat e vendosura nga BE-ja prej 1600 ton në vit përbushen shumë shpejt.

AFI zhvilloi një takim konsultativ mes disa kompanive që operojnë në këtë sektor dhe Z. **Arjan Palluqi**, Drejtor i Drejtorisë së Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë.

Mark Babani, sipërmarrës i kompanisë Mare Adriatik, **Gazmir Alcani** – kompania Poseidon, **Helidon Rugia** – kompania Coral, **Roland Kristo** – kompania Rozafa, **Artur Mata** nga kompania Konservim Adriatik, thanë se nëse ndodhen përballë vështirësive serioze dhe rrezikojnë mbylljen e aktivitetin nëse nuk zgjidhet çështja e kuotave.

Z. Arjan Palluqi, Drejtor i Drejtorisë së Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë, tha se kjo çështje do të ngrihet në mbledhjen e ardhshme të "Komitetit të Stabilizim Asociimit" në Bruksel.

"Në mënyrë që argumentet tona për shtimin e kuotave të jenë të suksesshme kërkohet një dokument i detajuar me propozime nga industria e përpunimit të peshkut" u shpreh Z. Palluqi.

Ndërsa **Alban Zusi**, Drejtor Ekzekutiv i AFI, tha se AFI së bashku me bizneset e këtij sektori do të vijojnë lobimin edhe me ambasadat e akredituara në Tiranë, pasi këto kompani e dërgojnë prodhimin e tyre në Spanjë, Itali dhe Kroaci.

"Nëse gjatë mbledhjes së Tetorit në Bruksel ky problem nuk do të marrë zgjidhje në tryezën teknike, atëherë do t'i kërkojmë qeverisë një zgjidhje në kontekstin social-politik" propozoi Alban Zusi

100 milion euro
investime nga kompanitë
4000 të punësuar
1600 ton
kuota e eksportit drejtë BE-s



Kuotat e përpunimit të peshkut, rrezikohen mijëra vende pune



Prodhuesit e bulmetit kërkojnë rregull dhe standarde



Dhjetë kompanitë kryesore të prodhimit të bulmetit në Shqipëri, anëtarë të “Albanian Food Industry” gjatë një takimi zhvilluar në Tiranë, kërkojnë rregulla të ndershme dhe standarde në sektorin e përpunimit të qumështit.

Alban Zusi drejtor ekzekutiv i AFI, iniciues i këtij takimi, u shpreh se ka ardhur koha që ky sektor t’i përgjigjet sfidave të shumta posaçërisht në shtimin e standardeve.

Ai prezantoi strukturën e re të AFI, e cila do t’i vijë në ndihmë fuqizimit të shoqatës për të qenë një zë i fuqishëm përfaqësues i këtyre bizneseve.

Erzen Begaj president i kompanisë Erzeni, propozoi që në kuadër të dëgjësave që pritet të ndërmarrë kryeministri Edi Rama, të zhvillohet një takim edhe me prodhuesit e bulmetit dhe ti

paraqitet një platformë e qartë me propozime.

Sakaq **Arben Ndreka**, president i kompanisë Lufra, u ndal tek informaliteti.

“Pavarësisht se qeveria ka ndërmarrë shumë aksione për të minimizuar informalitetin, shikojmë se baxho të shumta grumbullimi dhe përpunimi të qumështit, vijojnë të ekzistojnë duke prodhuar pa asnjë lloj standardi. Ky fenomen, po na shkatërron investimet tona miliona euro në fabrikat që kemi” tha Ndreka.

Për **Orhan Milotin** president i kompanisë AlbaMilk në Shkodër, duhet një sensibilizim më i madh në media për rreziqet nga produktet e bulmetit që shiten në rrugë si dhe pasja e një laboratorit “BaktoScan” ku analizat për përmbajtjen e ngarkesës bakteriologjike të zhvillohen në pak minuta.



Grup pune DPT-AFI për problematikat e industrisë së qumështit

Me iniciativën e Drejtorit Ekzekutiv të AFI-t Z. Alban Zusi dhe me kërkesë nga disa anëtarë të AFI, kompani të përpunimit të qumështit, zhvilluan një takim konsultativ në DPT, ku u parashtruan disa probleme të mprehta që shqetësojnë këtë sektor.

Në të njëjtën tryezë me bizneset u ulën dhe dëgjuan shqetësimet e tyre, Zj. Vasilika Vjetro Drejtoreshë e Përgjithshme e Tatimeve, Z.Xhavit Curri, Zv/ Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve Zj. Enkeleida Pipa Drejtoresh e Tatim paguesve të mëdhenj, si dhe Zj. Ilda Koja, Drejtoresh ligjore dhe teknike.

Dhjetë përfaqësuesit e kompanive kryesore të përpunimit të qumështit në vend gjatë takimit si emergjente kërkuar zgjidhjen e këtyre dy problemeve.

- Pagesa me TVSH e marrjes së qumështit nga çdo fermer . Kjo krijon vështirësi pasi janë rreth 2.000-3.000 fermerë në ditë, dhe është e pamundur të priten faturat e TVSH-s.

- Shitja me TVSH e produktit të fabrikave dhe për subjektet që nuk janë objekt i TVSH-s, për dyqanet e vogla etj. Shumë dyqane nuk pranojnë të marrin me faturë dhe kjo krijon vështirësi për fabrikat.

Si emërues i përbashkët i gjithë subjekteve, ishte që vetëm FORMALIZIMI i sektorit është zgjidhja për gjithë sistemin. Sipas disa statistikave vetëm rreth 13% e sektorit të qumështit është formal.

Ne fund u ra dakord, të ngrihet një grup punë me përfaqësues nga DPT-AFI dhe kompanitë e përpunimit të qumështit që ti propozohet zgjidhje ligjore qeverisë.



Zgjidhet kryetari dhe bordi drejtues i "Komitetit të Industrisë së Qumështit"

Shoqata AFI zhvilloi një takim me anëtarët, të cilët operojnë në sektorin e përpunimit të qumështit.

Takimi kishte si qëllim krijimin e "Komitetit të Industrisë së Qumështit" për institucionalizimin e vendimmarrjes dhe kontakteve me institucionet shtetërore, për të qenë sa më eficient në zgjidhjen e problemeve që ka kjo industri.

Gjatë diskutimeve anëtarët e AFI ranë dakord, që bordi drejtues i "Komitetit të Industrisë së Qumështit" të jetë me katër anëtarë.

Me votim të fshehtë u zgjodhën në bordin drejtues: Arben Ndreka/ Lufra, Nikolla Gjoni/ Gjiofarma, Orhan Miloti /Albamilk, Elivar Golemi /Agroal.

Gjithashtu po me votim të fshehtë u zgjodh edhe kryetari i bordit **Z. Arben Ndreka**, me një mandat 1 vjeçar. Pas tij për vitin në vazhdim, këtë post do ta mbajë, Z. Nikolla Gjoni pasi kishte vota të barabarta.





Tre kompani antarësohen në AFI dhe ALB Export

A.M.G sh.p.k

A.M.G shpk është një kompani private e themeluar nga vëllezërit Goxha me zyra të vendosura në Tiranë, Shqipëri. Kompania e themeluar në 2001 si rezultat i kërkesës në rritje të tregut lokal për ushqime të ngrira.

Kompania A.M.G sh.p.k është një importues i besuar dhe distributor i produkteve të ngrira cilësore dhe e specializuar në akullore, mish derri, mish pule, pasta, prodhime deti dhe perime.

Si një nga importuesit kryesorë të industrisë së ngrirë në Shqipëri, A.M.G shpk mban shumë prej markave kryesore të botës, si Algida, Ioniki, Yupik dhe Siblou, etj. Të gjitha këto marka plotësojnë ose tejkalojnë standardet globale të cilësisë, si dhe sigurinë dhe higjienën e ushqimit.



Kompania A.M.G sh.p.k

Pëllumb Bërzeshta

Ferma e sipërmarrësit Pëllumb Bërzeshta u ngrit gjashtë vite më parë si një iniciativë private për të kultivuar një nga frutat më të vlerësura për efektet pozitive në shëndetin e njeriut, shegën.

Pëllumbi ndërtoi me një teknologji bashkëkohore shtatë hektarë me shegë në njësinë administrative Kozare, të bashkisë Kuçovë, qarku i Beratit.

Në këtë fermë, e cila tashmë ndodhet në prodhimtari të plotë, kultivohen varietete lokale të shegës të cilat vlerësohen për pamjen e tyre atraktive, shijen e veçantë të frutit dhe lëngut. Në këtë mënyrë ferma e Pëllumbit përfaqëson jo vetëm sipërmarrjen bujqësore Shqiptare por edhe shijen e frutave vendase.



Pëllumb Bërzeshta

Gjirofarma Sh.p.k

Fabrika e Gjirofarm ndodhet në një vend piktoresk vetëm pak kilometra larg qytetit të Gjirokastrës. E njohur për aplikimin e teknologjisë më të re në Europë, produktet e Gjirofarm janë duke rrëmbyer vendin e parë në tregun vendas.

Produktet me logon "Gjirofarm" prodhohen nga qumështi tepër cilësor i bagëtive që kullosin në rajonin e Gjirokastrës.

Qumështi i sapo mjelë ruhet në temperaturë të ulët që nga momenti i grumbullimit deri në kohën kur fillon përpunimi i tij në fabrikë.

Qumështi i grumbulluar në termusat e përshtatshëm kalon më pas në fazën e kontrollit laboratorik, standartizimin dhe pjesën e mëtejshme të procesit.

E gjithë kjo punë e kujdeshme dhe profesionale, ka bërë që "Gjirofarm" të certifikohet nga Sistemi HACCP (Hazard Analysis and Critical Control Point) për kontrollin e cilësisë, sigurisë dhe zbatimit të standardeve më të larta në prodhimin e produkteve të bulmetit.



Gjirofarma Sh.p.k

Ligji i ri. Të gjitha bizneset duhet të instalojnë kamera sigurie

Të gjitha bizneset dhe objektet private e publike do të pajisen me kame-ra të cilësisë së lartë.

Gjykata Kushtetuese ka lënë këtë të martë në fuqi ligjin për "masat shtesë të sigurisë publike", i cili shkoi për shqyrtim në këtë gjykatë.

Vendimi i Kushtetueses ka qenë unanim, duke rrëzuar kërkesën e depozituar nga përfaqësues të biznesit, të cilët e quajtën antikushtetues detyrimin për të vendosur kamera sigurie me pamje video me cilësi të lartë dhe për t'i vendosur në dispozicion të drejtësisë në çdo rast pamjet.

Qëllimi është krijimi i kushteve ligjore për sigurimin e bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe subjekteve publike e private.

Ligji 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"

Është aprovuar nga Parlamenti ligji 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

Sipas këtij ligji për shoqëritë me mbi 100 punonjës lindin disa detyrime konkrete për krijimin e një strukture të re brenda çdo shoqërie, e cila ka detyrë të grumbullojë, regjistrojë dhe shqyrtojë sinjalizimet e ndryshme.

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive e Konfliktit të Interesave, si institucion qendror për ndjekjen e zbatimit të këtij ligji ka nxjerrë udhëzime dhe ka dërguar informacion për përmbushjen dhe formën e raportimit.

Kodi Doganor, i ri doganor që prej 01 Qershor 2017

Që prej datës 1 Qershor 2017 ka hyrë në fuqi kodi i ri doganor.

Ky kod ka shumë përmirësime në procedura nga ai i pari. Bizneset mund të vizitojnë faqen [online](#) të DPD për më shumë informacione rreth kodit të ri doganor. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave thotë se një ndër sfidat kryesore në thjeshtëzimin e procedurave lidhet me mundësimin bizneseve ti kryejnë të gjitha veprimet online deri me 31 Dhjetor 2021.

Kjo nisëm e DPD vjen pas miratimit të kodit të ri doganor i përafuar me atë të BE-s.



Mbahemi në kontakt



Adresa

Rr. "Gjin Bua Shpata", Pallatet e Aviacionit të Vjetër, Shk. 4, Kati i I, Ap.16, Tiranë



+355 67 604 52 40



email

center@albania-export.com



web

<http://afi.albania-export.com>
<http://afi.albania-export.com>



/ALB.Export
/AlbanianFoodIndustry
/PlatformABU

